



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM

K.P.P. 170/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.03. 2019, shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së lidhur me refuzimin e ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “A&E Engineering” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “*Shërbim Konsulence*”, me objekt “*Supervizion punimesh rehabilitim i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja Loti 2*”, me nr. REF-86052-09-17-2018, me fond limit 10,691,597.64 lekë pa TVSH, zhvilluar (faza III) në datën 20.11.2018, nga autoriteti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së lidhur me refuzimin e ofertës ekonomike të BOE “IKN” sh.p.k. & “Geostat Group” sh.p.k, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:

Operatori ekonomik “A&E Engineering” sh.p.k..
Adresa: Rr. “Islam Alla”, Pallati IVEA, 3/5, Tiranë.

BOE “IKN” sh.p.k. & “Geostat Group” sh.p.k.
Adresa: Rr. “Eduart Mano”, P.20, K 0, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Autoriteti Rrugor Shqiptar
Adresa: Rr. “Sami Frasheri”, Nr.33, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet dhe pretendimet me shkrim të operatorëve ekonomik ankimues, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I*****Vlerësimi paraprak***

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave dhe të dokumentacionit të dërguar nga operatorët ekonomik ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, operatorët ekonomik ankimues kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashut, KPP konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Operatorët ekonomik kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, kanë paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesave të operatorëve ekonomik ankimues.

II***Rrethanat e çështjes***

II.1 Në datën 18.09.2018 në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Shërbim Konsulence*”, me objekt “*Supervizion punimesh rehabilitim i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja Loti 2*”, me nr. REF-86052-09-17-2018, me fond limit 10,691,597.64 lekë pa TVSH, zhvilluar (faza III) në datën 20.11.2018, nga autoriteti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar.

II.2 Në datën 28.09.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e parë të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.3.Në datën 08.10.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.4.Në datën 18.10.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë të kualifikuar, për paraqitjen e propozimeve teknike dhe ekonomike në datë 05.11.2018, për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.5.Në datën 05.11.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e dytë të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në të cilën kanë paraqitur propozime operatorët ekonomik si më poshtë:

1. "A&E Engineering" shpk,
2. "Archispace" shpk & "AVE Consulting" shpk
3. "IKN" shpk & "Geostat Group" shpk

II.6.Në datën 12.11.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë, mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për propozimet teknike, ku rezulton si më poshtë vijon:

- | | |
|--|------------|
| 1. "Archispace" shpk & "AVE Consulting" shpk | 85.00 pikë |
| 2. "IKN" shpk & "Geostat Group" shpk | 80.66 pikë |
| 3. "A&E Engineering" shpk, | 70.00 pikë |

II.7.Në datën 20.11.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e tretë të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në të cilën ka kryer hapjen e zarfave me propozimet ekonomike, të operatorëve ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

- | | |
|--|-------------------------|
| 1. "Archispace" shpk & "AVE Consulting" shpk | 7,400,000 lekë pa tvsh |
| 2. "IKN" shpk & "Geostat Group" shpk | 4,380,000 lekë pa tvsh |
| 3. "A&E Engineering" shpk, | 10,250,000 lekë pa tvsh |

II.8.Në datën 07.12.2018, me anë të shkresës 7944/5prot., datë 07.12.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik "A&E Engineering" sh.p.k, për refuzimin e ofertës së tij ekonomike me argumentimin si më poshtë vijon:

"[...] 3. Operatori ekonomik "A & E Engineering" shpk në ofertën ekonomike të paraqitur, sipas veprimeve aritmetike të verifikuara, rezulton gabim aritmetik në masën 6.82 %. Ky gabim rezulton në pikën 4 ing. Gjeolog nga 60,000 leke e ofertuar sipas llogaritjeve del 2 502 leke; pika 5 ing. Elektrik nga 180,000 leke e ofertuar del 22,500 leke; pika 6 ing. Mekanik/ Mbikqyrës i sinjalistikës nga 640,000 leke e ofertuar del 213,312 leke; pika 7 ing. Mjedisit nga 60,000 leke e ofertuar del 2,502 leke . Pas korrigjimeve te veprimeve aritmetike, në total vlera e ofertuar nga 10,250,000 leke (pa tvsh) del 9,550,816 leke (pa tvsh). Bazuar në VKM nr. 914 datë 29.12.2014 i ndryshuar, neni 66 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave" pika 4..... " Oferta me gabime aritmetike refuzohet kur shuma absolute e të gjitha korrigjimeve janë më shumë se ± 2 % e vlerës ekonomike të ofruar", KVO refuzon ofertën financiare të paraqitur.[...]"

II.8.1.Në datën 14.12.2018 operatori ekonomik ankimes "A&E Engineering" sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së lidhur me refuzimin e ofertës së tij ekonomike, duke argumentuar si më poshtë vijon:

"[...]Persa me sipër. Referuar Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar me Ligjin Nr. 9800, datë 10.09.2007, Ligjin Nr.9855, datë 26.12.2007, Ligjin Nr. 10170, datë 22.10.2009, Ligjin Nr.10 309, datë 22.07.2010, Ligjin Nr. 22/2012, Ligjin Nr. 131/2012, Ligjin Nr. 182/2014 dhe Ligjin Nr. 47/2017 "Per prokurimin publik "dhe ne baze te VKM-se Nr.914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" ,ju bejme me dije se vleresimi i propozimit ekonomik jepet ne daten dhe oren e percaktuar, c'ka nenkupton se edhe cdo lloj gabimi aritmetik ne llogaritje transmetohet njeheresh , dhe shenohet ne procesverval, kur jane te pranishem te gjithe anetaret e Komisionit dhe vete operatoret ekonomike pjesmarres ne proceduren perkatese, ne te kundert cdo lloj procedure tjeter e ben Vleresimin ekonomik automatikisht te pavlefshem. Perverc kesaj, edhe vete Dst (Dokumentat Standarte te Tenderit) dhe perkatesisht ne faqen 13 te saj me objekt prokurimi "Supervizion punimesh rehabilitimi i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotllimi Shqiponja, Loti 2" percakton qe: Autoriteti Kontraktor i dërgon njoftimin për ditën dhe orën e hapjes së propozimeve ekonomike të gjithë kandidatëve, propozimet ekonomike të cilëve do të hapen. Në datën dhe orën e përcaktuar, Autoriteti Kontraktor hap propozimet ekonomike. Ofertuesit ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar do të lejohen të ndjekin hapjen e propozimeve. Zarfë ku shkruhet "Propozimi Ekonomik" për secilin propozim që nuk është refuzuar më parë do të hapet dhe informacioni i mëposhtëm do të shpallet e regjistrohet: Emri i Ofertuesit, rezultati i vlerësimit të propozimit teknik. Çmimi i propozuar, siç shprehet në propozimin ekonomik. Autoriteti kontraktor percakton nese propozimet ekonomike jane te plota, korrigjon ndonje gabim aritmetik dhe per qellime krahasimi e vleresimi, i konverton te gjitha cmimet e propozimit ne nje monedhe te vetme. Autoriteti Kontraktor rendit dhe cakton nje rezultat per cdo propozim ekonomik. Autoriteti Kontraktor korrigjon ato gabime në propozimin ekonomik, që janë thjesht të një natyre aritmetike, nëse gabimi zbulohet gjatë shqyrtimit të propozimeve. Autoriteti Kontraktor njofton menjëherë Ofertuesin në fjalë me një njoftim me shkrim/elektronik mbi çdo korrigjim të tillë dhe mund të vazhdojë me ndryshimin e gabimit, me kusht që Ofertuesi t'a ketë miratuar këtë komunikim që i është bërë. Nëse Ofertuesi refuzon të pranojë korrigjimin e propozuar, atëherë propozimi do të refuzohet, pa konfiskim të sigurimit të ofertës, nëse ekziston një e tillë. Gabimet në llogaritjen e çmimit do të korrigjohen nga Autoriteti Kontraktor, sipas shëmbujve mëposhtme: -në rast se ka mospërputhje ndërmjet shumave të shprehura në shifra dhe atyre në fjalë, atëherë do të mbizotërojnë shumat e shprehura në fjalë, me përjashtim të rasteve kur shuma në fjalë lidhet me një gabim aritmetik, -nëse ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe vlerës së përgjithshme që merret nga shumëzimi i çmimit njësi dhe sasisë, atëherë do të mbizotërojnë çmimi njësi, dhe rrjedhimisht duhet të korrigjohet shuma në total, -nëse ka një gabim në një shumë total, që korrespondon me mbledhjen ose zbritjen e nëntotaleve, atëherë do të mbizotërojnë nëntotali dhe totali duhet të korrigjohet. Shumat e korrigjuara në këtë mënyrë janë të detyrueshme për ofertuesin. Nëse ofertuesi nuk i pranon ato, atëherë oferta e tij do të refuzohet.

Persa i perketparagrafit te mesiperem, sqarojme se nuk ka pasur asnje lloj njoftimi nga ana e Autoritetit Kontraktor dhe si rrjedhoje as refuzim nga operatori ekonomik "A&E Engineering" sh.p.k ne lidhje me korrigjimin e propozuar ne fazen e dyte te procedures se prokurimit "Supervizion punimesh rehabilitimi i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja Loti 2" me fond limit 10 691 597,64 (dhjete milion e gjashteqind e nentedhjete e nje mije e peseqind e nentedhjete e shtate presje gjashtedhjete e kater) leke pa Tvsh. Persa i perket tabelës

se ofertes financiare te paraqitur nga operatori ekonomik "A&E Engineering" sh.p.k dhe menyres se llogaritjeve aritmetike nga ana e autoritetit tuaj, sqarojme se kolona e dyte (Sasia) qe eshte shprehur me vlerat ne perqindje ka te beje me prezencen e inxhinierve perkates ne objektin ne fjale, dhe jo me pagat e gjithsecilit prej tyre, njedhimisht dhe vlera totale e llogaritur nga Autoriteti juaj nuk korrespondon me vlerat perkatese te kolones se pare dhe te dyte.[...]"

II.8.2. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 11364/2 Prot. datë 21.12.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues "A&E Engineering" sh.p.k, duke mos e pranuar ankesën.

II.8.3. Në datën 27.12.2018 operatori ekonomik ankimues "A&E Engineering" sh.p.k ka paraqitur, ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur në autoritetin kontraktor.

II.9. Në datën 13.12.2018, me anë të shkresës 7944/5prot., datë 07.12.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar BOE "IKN" sh.p.k. & "Geostat Group" sh.p.k., për refuzimin e ofertës së tij ekonomike me argumentimin si më poshtë vijon:

"[...].1. Operatori ekonomik "Instituti i Konsulences se Ndertim & Geosat Group " ka paraqitur oferten financiare ku pagat mujore për mbikqyresit: inxhinier per sigurine rrugore dhe inxhinier mjedisi janë ofertuar 20 000 (njezet mijë) leke, pas shpjegimeve të dhëna nga BO, konstatuam se kjo në kundërshtim me VKM nr. 399 dt. 03.05.2017 " Për Përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi pika 1 citoj " Paga bazë minimale, mujore, për punonjësit, në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga cdo personjuridik a fizik, vendas ose të huaj, të jetë 24 000 (njëzet e katër mijë) lekë". Në këto kushte KVO refuzon oferten financiare të BO "Instituti i Konsulences ne Ndertim shpk & Geosat Group shpk"[...]"

II.9.1. Në datën 18.12.2018 BOE ankimues "IKN" sh.p.k & "Geostat Group" sh.p.k ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së lidhur me refuzimin e ofertës së tij ekonomike, duke argumentuar si më poshtë vijon:

"[...] Me shkresën tuaj nr.10672 prot. datë 26.11.2018, të cilën e kemi marrë zyrtarisht nga posta me date 3 Dhjetor 2018 "Mbi kërkesën për shpjegime për elementët e ofertës", drejtuar bashkimit tonë të operatorëve, na kërkoni bazuar në LPP dhe në VKM nr.914, neni 66, pikat 4, 5 dhe 6, ku i referoheni situatave të ofertës anomalisht të ulët, shpjegime për pagesat ditore (mënyrën e llogaritjes), si edhe për kolonën "çmimi" në preventivin e punimeve. Kësaj shkrese ne i kemi kthyer përgjigje brenda afatit të kërkuar nga ju si AK pra me datë 04 Dhjetor 2018 para orës 9.00 duke dhënë shpjegimet tona pavaresisht fakteve që: - së pari kërkesa juaj nuk ishte e bazuar në VKM 66, pika 4,5 dhe 6 është në kundërshtim me LPP nenin 55 (Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese) pika 2 e tij e cila thotë: Autoriteti kontraktor vlereson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit. Nuk duhet të përfshihet asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentat e tenderit. -së dyti kërkesa për këtë shpjegim ka qëne jashtë afatit që percakton VKM nr. 914 neni 66 pika 6 paragrafi i fundit i tij i cili thote: Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë vetëm me shkrim ose të pasqyruara në procesverbal. Në bazë të ofertave të pranuar, komisioni i vlerësimit të ofertave harton renditjen përfundimtare, e cila duhet të komunikohet në kohën e njoftuar por në cdo rast jo më vonë se 10 dite nga dorezimi i ofertave.

(Ndërkohë sic dihet ofertat presupozohen të dorëzuara në ditën e hapjes me datë 20 Nëntor ditë në të cilën ju keni hartuar procesverbalin nr 6 me renditjen perfundimtare i cili mban datën 20.11.2018 dhe nuk ka vend për analizë ofertash) Afati i sipërpërmendur ka qënë data 30 Nëntor 2018, pra cdo veprim pas kësaj date është i pavlefshëm. Në nenin 3 të LPP, jepën përkufizimet e termave të përdorura në ligj. Konkretisht pika 3 e tij, ku thuhet: "Kontratat e konsulencës" janë kontratat për shërbime publike konsulence, të një natyre intelektuale dhe këshilluese, duke përfshirë llojet e tjera të shërbimeve, ku mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë." Më tej, në pikën 5 të po këtij neni jepën përkufizimi për kontratat e shërbimeve, duke i ndarë qartësisht ato nga njëra tjetra që në nenin e përkufizimeve. Pra sipas ligjvënësit, kontrata e shërbimeve dhe kontrata e shërbimit të konsulencës janë dy lloje të ndryshme kontratatsh, prandaj trajtohen ndryshe nga legjislacioni edhe në mënyrën e zhvillimit të tyre. Ju citoni nenin 56/1 si referencë për skualifikimin tonë. Kjo pikë përcakton se: "Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës." Ky nen nuk gjen aplikim në procedurën për të cilën ankohemi, pasi kjo nuk është procedurë konkurimi për mallra, punë apo shërbime, sikurse ky nen përcakton. Kjo është procedurë shërbimi konsulence që nuk përfshihet nga ligjvënësi në këtë nen. Ju citoni nenin 66/6, paragrafin e dytë, të VKM nr.914, për rregullat e prokurimit, ku përcaktohet se: "Më pas, komisioni i vlerësimit të ofertave vazhdon vlerësimin e ofertave teknike të kandidatëve të kualifikuar dhe bën klasifikimin teknik. Komisioni i vlerësimit të ofertave kalon në shqyrtimin e ofertës ekonomike dhe verifikon nëse ka gabime aritmetike apo çmim anomalisht të ulët sipas përcaktimeve në pikat 4 dhe 5, të këtij neni." Në pikën 5, të nenit 66, që ju citoni, përcaktohet se: "Pas korigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse oferta e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:..." Po t'u referohemi DST-ve të publikuara nga ju për këtë procedurë, të cilat janë bazuar në DST të hartuara nga APP, nuk përcaktohet fare ndonjë formulë për ofertat anomalisht të ulëta, madje as nuk përmenden ato në rubrikën Udhëzime për ofertuesit, sikurse ndodh me DST të procedurave të tjera të prokurimit. Pra ligj i e diferencon këtë procedurë, po kështu VKM dhe dokumentet standarde të tenderit, ndërkohë KVO vepron në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, duke bërë një përlllogaritje formale thjesht me arsyen e vetme për të na skualifikuar pa shkak të ligjshëm. Shërbimet e konsulencës janë shërbime të një natyre intelektuale, sikurse përcakton ligji, për këtë arsye nuk aplikohet kriteri i çmimit më të ulët, e për rrjedhojë as ndonjë formulë për ofertë anomalisht të ulët. Por edhe nëse do të aplikohesh, ne ju kemi paraqitur gjithë dokumentacionin e marrë nga institucioni përgjegjës, që provon se edhe dy individët/ekspertët e përmendur nga ju, janë pjesë e listpagesave tona prej vitesh, duke respektuar jo vetëm kriterin e pagës minimale në shkallë vëndi, por edhe më tej. Ndërkohë që në këtë propozim tonin ashtu dhe sic e keni kërkuar dhe ju në Termat e Referencës do të jene te angazhuar me kohë të pjesëshme, për këtë kontratë, është menduar se kontributi i tyre do të ketë këtë përfshirje në terma financiare. Ekspertët në fjalë nuk janë të punësuar vetëm për këtë projekt, por ata janë pjesë e stafit të kompanisë. Duam të shtojmë faktin që oferta jonë është paraqitur sipas DST shtojca 4 ndërsa tabela e përcaktimit të tarifave e vendosur në Termat e Referencës është indikative dhe kjo vihet re qartë pasi nuk plotëson të gjitha rubrikat që kërkon shtojca 4 e DST-së. Gjthashtu vërehet qartë që në termat e referencës paragrafi i fundit VII MËNYRA E PAGESËS. PAGESA DO TË BËHET MUJORE NË BAZË TË % SË REALIZIMIT TË PUNIMEVE TË ZBATIMIT E ZBËRTHYER SIPAS SHPENZIMEVE MUAJ-NJERI NË ZBATIM TË KUSHTEVE TË PAGESËS NË KONTRATË.

a mund te na shpjegoni ju si Autoritetet nisur nga ekperiencat e deritanishme cfare ndodh nëse punimet e zbatimit mbarojnë më shpejt apo e kundërta, e zvogëloni apo shtoni kontratën e shërbimit të konsulencës. Referuar procesverbalit nr.7, të datës 06.12.2018, ne jemi i vetmi Operatori mbetur në garë. Duke mos qenë të preferuarit tuaj, meqë oferta jonë nuk kishte asnjë mangësi, ju keni keqaplikuar ligjin, duke përdorur ofertën anomalisht të ulët dhe duke e aplikuar gabimisht atë.[...]”

II.9.2. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 11510/1 Prot. datë 26.12.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje BOE ankimues “IKN” sh.p.k & ”Geostat Group” sh.p.k, duke mos e pranuar ankesën.

II.9.3.Në datën 31.12.2018 BOE ankimues “IKN” sh.p.k & ”Geostat Group” sh.p.k ka paraqitur, ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur në autoritetin kontraktor

II.10.Në datën 11.01.2019 autoriteti kontraktor me anë të shkresave nr.106/1prot., datë 10.01.2019 dhe nr.333prot., datë 10.01.2019, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.11.Në datën 24.01.2019, me anë të shkresës nr.1967/3prot. dhe në datën 18.03.2019, me anë të shkresës nr.1967/5, Komisioni i Prokurimit Publik ka kërkuar informacion dhe dokumentacion shtesë nga autoriteti kontraktor lidhur me procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.12.Me anë të shkresave nr.979/1prot., datë 08.02.2019 dhe nr.2746/1prot., datë 21.03.2019, autoriteti kontraktor ka paraqitur dokumentacionin dhe infomacionin shtesë të kërkuar nga Komisioni i Prokurimit Publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dhe kërkesave të operatorëve ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të ankimuesve, në zbatim të nenit 30 pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, në të cilin parashikohet se “1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përbashimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre”, referuar informacionit të autoritetit kontraktor për shkaqet e skualifikimit të BOE ankimues “IKN” sh.p.k & ”Geostat Group” sh.p.k, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe veprimet e ndërmarra kryesisht nga autoritetit kontraktor gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

III.1.1. Marrë shkas nga arsyeja e skualifikimit të BOE ankimues “IKN” sh.p.k & ”Geostat Group” sh.p.k, nga verifikimi i dokumentave të tenderit nga autoriteti kontraktor, në bazë të të cilave është bërë më pas edhe shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se fondi limit i procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi është përlogaritur në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe konkretisht vëren se:

III.1.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor me shkresën nr.2746/1prot., datë 21.03.2019, KPP konstaton se përlogaritja e fondit limit për procedurën e prokurimit objekt ankimi, nga ky i fundit është bërë, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

III.1.3. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” sipërcituar në nenin 1 të tij “Fusha e Veprimit” parashikon shprehimisht se: *Ky manual i tarifave vlen për llogaritjen e pagesave për të gjitha shërbimet e planifikimit, projektimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të kryera nga arkitektët dhe inxhinierët (porosimarrës) të financuara me fonde publike, të financuara me fonde publike, të përfshira në listën e punimeve të këtij manuali.*

Ndërsa në nenin 7 të saj parashikohet shprehimisht se: *Tarifat për shërbimet duhet të jenë në një vlerë ndërmjet tarifave minimale dhe maksimale të përcaktuara në këtë manual në përputhje me LPP. Pika 3 e nenit 7 parashikon se: Në rrethana të jashtëzakonshme dhe nëse dokumentohet me shkrim tarifat edhe mund të jenë më të ulëta se sa tarifa minimale të specifikuara nga ky manual.*

III.1.4. Në Rekomandimin Nr. 5585 Prot datë 25.07.2017 të APP-së; “Rekomandim mbi menyren e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, parashikohet si më poshtë:

- *Per shërbimet e parashikuara në vendimin e sipërcituar (Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354, datë 11.05.2016), APP rekomandon që, krahas përlogaritjes së fondit limit (i cili përlogaritet nisur nga përqindja maksimale e lejuar), behet përlogaritja e vlerës minimale të lejuar (e cila përlogaritet nisur nga përqindja minimale e lejuar), në varesi të kategorisë dhe grupit tarifor, ku bën pjesë objekti i prokurimit*
- *Ne nenin 7, pika 3, të vendimit të sipërcituar, parashikohet se: "Në rrethana të jashtëzakonshme dhe nëse dokumentohet me shkrim, tarifat edhe mund të jenë më të ulëta se sa normat minimale, të specifikuara nga ky manual".*
- *Ne këtë kontekst rekomandojmë që, në rastet kur nuk dokumentohet rrethana të jashtëzakonshme, autoritetet kontraktore gjatë vlerësimit të ofertave, duhet t'i referohen vlerës minimale të përlogaritura për secilin rast, në bazë të parashikimeve në VKM Nr. 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje edhe kolaudim".*
- *Ne paraqitjen e ofertave në këtë lloj procedure prokurimi, operatorët ekonomikë duhet të mbajnë në konsideratë edhe vlerat minimale të përlogaritura nga autoritetet kontraktore në zbatim të VKM Nr. 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje edhe kolaudim".*

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik argumenton se në rastin konkret, nisur nga informacioni dhe dokumentacioni i detajuar i dhënë nga autoriteti kontraktor, kryesisht në lidhje me përlllogaritjen e fondit limit, si edhe përcaktimin e vlerave minimale e maksimale të mbikëqyrjes, autoriteti kontraktor si organi përgjegjës për zhvillimin e procedurës së prokurimit nuk ka përcaktuar në dokumentat e tenderit vlerën minimale krahas fondit limit të cilat duhet të jenë detyruesisht të aplikueshme për çdo operator ekonomik të interesuar. Gjithashtu, autoriteti kontraktor e ka përlllogaritur fondin limit sa vlera minimale e lejuar sipas grupit tarifor të zgjedhur nga vetë ky i fundit. Autoriteti kontraktor sqaron se në përlllogaritjen e fondit limit është bazuar në VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” dhe thekson se është zgjedhur grupi tarifor III. Argumentat e autoritetit kontraktor, ofrojnë dhe hedhin dritë mbi fakte dhe rrethana të reja, të cilat në raste të tjera të ngjashme nuk kanë qenë të njohura më parë dhe që mund të kishin ndikim në vendimmarrjen e KPP. Qëllimi i VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” është që të mbrojë profesionet të cilat merren me planifikim territori, projektim, mbikëqyrje e kolaudim, pra lidhet me punën intelektuale që do të bëhen, duke dhënë një punë cilësore, por me një vlerë mbi minimumin e lejuar të përcaktuar me një vendim të posaçëm. Kjo VKM e posaçme ka për qëllim të zgjidhë situatën e vështirë të krijuar në afrimin dhe përzgjedhjen e personave fizikë, apo juridikë të interesuar, të kontraktohen për shërbimet e kërkuara, pasi shpesh ka rezultuar edhe me uljen e cilësisë së shërbimit të ofruar; Efekti i zbatimit të kësaj VKM është rritja e cilësisë së produktit të marrë në fushën e studimit, projektimit, drejtimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit, nëpërmjet afrimit të profesionistëve të dalluar, duke përafuar nivelin e pagave që ato t’i përgjigjen realitetit të tregut të sotëm. Gjithashtu, referuar edhe frymës së legjislacionit të posaçëm në fuqi, në rast se nuk zbatohet kjo VKM e cila ka dalë për qëllim të posaçëm për të mbrojtur punën intelektualë që bëhet në fushën e këtyre shërbimeve, atëherë kjo VKM nuk ka më asnjë vlerë dhe do të humbiste qëllimin për të cilin ka dalë për zbatim, sepse vetëm nëse do të mbeteshim tek argumentimi i analizës së kostos nëse ajo do të rezultonte anomalisht e ulët, atëherë kjo analizë do të ishte shumë subjektive, aq më tepër kur autoriteti kontraktor mund të kërkonte sqarime nga operatorët ekonomikë nëse pas aplikimit të formulës për ofertën anomalisht të ulët, mbi ofertat brenda kufijve ligjorë, do të rezultonte se një apo më shumë oferta janë anomalisht të ulta.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, vlerësimi i ofertave është kryer duke aplikuar formulën për ofertën anomalisht të ulët referuar ligjit për prokurimin publik, dhe jo vlerave minimale, ndërkohë që operatorët ekonomik pjesëmarrës kanë paraqitur oferta të papërgjegjshme dhe nën kufirin e përcaktuar nga legjislacioni i posaçëm në fuqi “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, e cila është e detyrueshme për të gjithë operatorët ekonomikë, pasi ky legjislacion nuk lë në diskrecionin e një autoriteti kontraktor të pranojë argumentat për elementët e veçantë të ofertës ekonomike të operatorëve, përsa kohë që ajo është jashtë kufijve minimalë dhe maksimalë të tarifave.

III.1.6. Referuar shkrsës nr.2746/1prot., datë 21.03.2019të autoritetit kontraktor, rezulton se vlera minimale e për kryerjen e shërbimit të supervizionit për objektin “*Supervizion punimesh rehabilitim i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja Loti 2*” është në vlerën 10,691,597.6 lekë pa tvsh, e cila është edhe fondi limit i kontratës që do të prokurohet.

III.1.7.Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se përlllogaritja e fondit limit, është haptazi jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik si dhe atë sektorial, pasi shkakton ofrimin e vlerave të papërgjegjshme dhe nën minimumin e lejuar nga operatorët ekonomik. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik, bazuar në nenin 64, pika 3 të LPP – së, gjykon se situata e krijuar, përbën shkak për anulimin e kësaj procedure prokurimi, në përputhje me nenin 31 pika 2 gërma “d” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik” parashikohet se: “[...] Komisioni, pas shqyrtimit administrativ të ankesës vendos me akt të motivuar: d) Të anulojë procedurat për shpalljen e kontratës fituese dhe të udhëzojë autoritetin kontraktues për rifillimin e procedurës së prokurimit [...]”.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se pretendimet e ankimuesve nuk do të merren në shqyrtim në themel pasi procedura e prokurimit duhet të anulohet, kjo në përputhje me parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të mos marrë në shqyrtim ankesat e paraqitura nga operatori ekonomik “A&E Engineering” sh.p.k. dhe BOE “IKN” sh.p.k & ”Geostat Group” sh.p.k për procedurën e prokurimit, “Shërbim Konsulence”, me objekt “Supervizion punimesh rehabilitim i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja Loti 2”, me nr. REF-86052-09-17-2018, me fond limit 10,691,597.64 lekë pa TVSH, zhvilluar (faza III) në datën 20.11.2018, nga autoriteti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “A&E Engineering” sh.p.k. dhe BOE “IKN” sh.p.k & ”Geostat Group” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik..

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1967 protokoli Datë 27.12.2018;

Nr. 1983 protokoli Datë 31.12.2018;

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Nënkryetar
Enkeleda Bega**

**Anëtar
Vilma Zhupaj**

**Anëtar
Lindita Skeja**

**Anëtar
Merita Zeqaj**

**Kryetar
Evis Shurdha**